

Specialist/Sektor i Analizës së Riskut Kibernetik, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141 datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 12.12.2022 “Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK”, i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 36, datë 19.02.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin 233, datë 20.12.2023 ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike’, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/ Sektori Analizës së Riskut Kibernetik, Drejtoria e Analizës së Përputhshmërisë, Riskut dhe Kontrollit të Masave të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Kryen vlerësime të rregullta të rreziqeve të identifikuara nga infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme për të identifikuar dobësitë e mundshme dhe vlerësuar masat e marra nga to;
- Analizon kërcënimet kibernetike në zhvillim dhe vlerëson në nivel kombëtar ndikimin e tyre të mundshëm në infrastrukturën kritike dhe të rëndësishme;
- Analizon metodologjitë/strategjitë e menaxhimit të rrezikut të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme për të mitiguar dhe minimizuar ndikimin e kërcënimeve kibernetike.
- Mbështet palët e interesuara për të priorizuar dhe adresuar rreziqet e identifikuara bazuar në ashpërsinë dhe ndikimin e tyre të mundshëm në infrastrukturën e tyre;
- Krijon dhe zhvillon programe trajnimi dhe ndërgjegjësimi për të edukuar punonjësit e institucionit mbi praktikën më të mirë të menaxhimit të rreziqeve të sigurisë kibernetike;
- Bashkëpunon dhe ofron mbështetje metodike ndaj infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme lidhur me procesin e menaxhimit të rrezikut;
- Merr pjesë në identifikimin dhe analizën e riskut të aseteve në infrastrukturën e informacionit dhe në transmetimin tek infrastrukturën, me qëllim marrjen e masave për reduktimin e riskut;
- Përpunon dhe administron të dhënat statistikore në lidhje me analizën e riskut në infrastrukturën e informacionit.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Bachelor”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

Përvoja: Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 2 vjet përvojë në sektorët që trajtojnë dhe menaxhojnë sigurinë kibernetike, menaxhimin e rrezikut të teknologjisë së informacionit ose një fushë të ngjashme. Njohje me metodologjitë dhe mjetet e analizës së rrezikut kibernetik. Njohuri mbi standartin e sigurisë ISO 27001 dhe 31000.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Njohuri lidhur me ligjin për sigurinë kibernetike, standartet, metodologjitë dhe strategjitë e menaxhimit të rrezikut të TI-së.
- Procesin e identifikimit dhe menaxhimit të kërcënimeve kibernetike.
- Praktikën më të mirë të menaxhimit të rreziqeve të sigurisë kibernetike.
- Njohuri për sigurinë e rrjetit dhe sistemet e zbulimit/parandalimit të ndërhyrjeve.

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Përbëjnë avantazh certifikatat e avancuara (p.sh., CISSP, CISM, CRISC, CISA, ISO 27001 apo ekuivalente që lidhen me menaxhimin e riskut);
- Aftësi shumë të mira analize, organizimi, komunikimi, prezantimi dhe në gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-2)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 05.03.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);

- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.